

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Deklaratë e përbashkët për nenet 22 dhe 29 të Marrëveshjes

Palët deklarojnë se gjatë zbatimit të neneve 22 dhe 29 ata do të shqyrtojnë, në Këshillin e Stabilizim Asociimit, ndikimin e cilësdo marrëveshjeje preferenciale të negociuar nga Shqipëria me vendet e treta (me përjashtim të vendeve që përfshihen në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe vendet fqinje të cilët nuk janë anëtare të BE-së). Ky shqyrtim do të mundësojë rregullimin e koncesioneve shqiptare dhënë Komunitetit Evropian, nëse Shqipëria do të ofronte koncesione më të mira në masë të ndjeshme kundrejt këtyre vendeve.

Deklaratë e përbashkët për nenin 41 të Marrëveshjes

1. Komuniteti deklaron gatishmërinë e tij të shqyrtojë në Këshillin e Stabilizim Asociimit, çështjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në kumulimin diagonal të rregullave të origjinës menjëherë sa të krijohen kushtet ekonomike dhe tregtare ashtu si edhe kushtet që garantojnë kumulimin diagonal.
2. Duke pasur parasysh këtë, Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të krijuar zonat e tregtisë së lirë veçanërisht me vendet e tjera që përfshihen në Procesin e Stabilizim Asociimit të Bashkimit Evropian.

Deklaratë e përbashkët për nenin 46 të Marrëveshjes

Është kuptuar që nocioni “fëmijë” është përkufizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit përkatë pritës.

Deklaratë e përbashkët për nenin 48 të Marrëveshjes

Është kuptuar që nocioni “anëtarët e familjes së tyre” është përkufizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit përkatë pritës.

Deklaratë e përbashkët për nenin 61 të Marrëveshjes

Palët bien dakord që dispozitat e parashtruara në nenin 61 nuk do të interpretohen për të ndaluar kufizimet proporcionale dhe jodiskriminuese për blerjen e pasuri të paluajtshme bazuar në interesin e përgjithshëm, dhe as nuk ndikojnë në rregullat e Palëve që rregullojnë sistemin e pronësisë mbi pronën, me përjashtim të specifikuar.

Është kuptuar që blerja e pasurive të paluajtshme nga nënshtetasit shqiptare lejohet në Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian në përputhje me të drejtën e zbatueshme Komunitare, duke iu nënshtruar përjashtimeve specifike të përcaktuara dhe të zbatuara në përputhje me legjislacionet e zbatueshme kombëtare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

Deklaratë e përbashkët për nenin 73 të Marrëveshjes

Palët bien dakord që për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare përfshin veçanërisht të drejtën e autorit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë të drejtën e autorit për programet kompjuterike dhe të drejtat shoqëruese, të drejtat e bazave të të dhënave, patentat, dizenjot industriale, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, topografinë e treguesve gjeografikë të rretheve të integruar, duke përfshirë titullin e origjinës, ashtu si edhe mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme siç përmendet në nenin 10a të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe mbrojtjen e informacionit të padeklaruar mbi ekspertizën.

Deklaratë e përbashkët për nenin 80 të Marrëveshjes

Palët janë të vetëdijshme për rëndësinë që populli dhe Qeveria e Shqipërisë i kushtojnë perspektivës së liberalizimit të regjimit të vizave. Ndërkohë, progresi varet zbatimi nga Shqipëria i reformave më të rëndësishme në fusha siç është forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit të paligjshëm, forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe sigurinë e dokumenteve.

Deklaratë e përbashkët për nenin 126 të Marrëveshjes

1. Për qëllimet e interpretimit dhe zbatimit praktik të Marrëveshjes, Palët bien dakord që rastet tepër urgjente të përmendura në nenin 126 të Marrëveshjes janë ato raste kur ka shkelje materiale të Marrëveshjes nga njëra nga të dy Palët. Shkelje materiale të Marrëveshjes përbën:
 - mosnjohja e Marrëveshjes e pasanksionuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe
 - shkelje e elementëve thelbësore të Marrëveshjes të parashikuara në nenin 2
2. Palët bien dakord që “masat e duhura” të përmendura në nenin 126 janë masat e marra në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Nëse një Palë merr një masë në një rast tepër urgjent sipas nenit 126, Pala tjetër mund të përdorë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Deklaratë e përbashkët për migracionin e ligjshëm, lirinë e lëvizjes dhe të drejtat e punëtorëve.

Rinovimi ose refuzimi i lejeqëndrimit përcaktohet nga legjislacioni i secilit Shtet Anëtar dhe Marrëveshjeve dypalëshe dhe Konventave në fuqi ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare.

Deklaratë e Përbashkët për Principatën e Andorës
në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Principatën e Andorës që renditen në Kapitujt 25 deri në 97 të Sistemit të Kombinuar, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje.
2. Protokollin 4 zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklaratë e Përbashkët për Republikën e San Marinos
në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Republikën e San Marinos, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje.
2. Protokollin 4 zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklarate e Përbashkët për Protokollin 5 të Marrëveshjes

1. Komuniteti dhe Shqipëria vërejnë që nivelet e emetimeve të gazta dhe zhurma, aktualisht të pranuar në Komunitet për qëllime të miratimit të tipit të automjetit të rëndë të mallrave nga 01.01.2001,1 janë si më poshtë:

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Qëndrueshëm European (ESC) dhe testi i Reagimit të Ngarkesës Europiane (ELR):

		Masa e monoksidit të të karbonit	Masa e hidrokarboneve	Masa e oksideve të nitrogenit	Masat e materialeve grimcore	Tymi
		(Co) g/këh	(HC) g/këh	(Nox) g/këh	(PT) g/këh	m ⁻¹
Rradha A	Euro III	2.1	0.66	5.0	0.10 0.13 ^(a)	0.8

^(a) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min⁻¹

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Përkohshëm European

		Masa e monoksidit të karbonit	Masa e hidrokarboneve që nuk kanë përmbajtje metani	Masa e metanit	Masa e oksideve të nitrogjenit	Masa e materialeve grimcore
		(Co) g/kwh	(NMHC) g/kwh	(CH ₄) (b) g/kwh	(NOx) g/kwh	(PT) (c) g/këh
Rradha A	Euro III	5.45	0.78	1.6	5.0	0.16 0.21 ^(a)

- (a) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min¹
- (b) Vetëm për motorët me gaz natyror
- (c) E pazbatueshme për motorët e furnizuar me gaz.

2. Në të ardhmen, Komuniteti dhe Shqipëria do të përpiqen të pakësojnë emetimet e automjeteve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne të kontrollit të emetimit të automjeteve kombinuar me cilësinë e përmirësuar të karburantit të motorit.

¹ Direktiva 1999/96/i KE i datës 13 dhjetor 1999, OJ L 44/1, 16.2.2000 fq 1.

DEKLARATË E KOMUNITETIT

Deklaratë e Komunitetit në lidhje me masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti në bazë të Rregullores (EC) No 2007/2000.

Duke marrë në konsideratë masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti European për vendet pjesëmarrëse ose ato të lidhura me Procesin e Stabilizim Asociimit, duke përfshirë Shqipërinë, në bazë të Rregullores (EC) Nr. 2007/2000, Komuniteti European deklaroi se:

- në zbatim të nenit 30 të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen ato masa unilaterale të tregtisë autonome të cilat janë më të favorshme si shtesë e koncesioneve tregtare kontraktuale të ofruara nga Komuniteti në këtë Marrëveshje për aq kohë sa Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 2007/2000 e ndryshuar zbatohet;
- veçanërisht për produktet e mbuluara nga Kapitulli 7 dhe 8 i Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilën Tarifa e Përbashkët Doganore parashikon aplikimin e tarifave doganore *ad valorem* dhe një tarifë doganore specifike, ky reduktim zbatohet gjithashtu në tarifat doganore specifike në derogim të dispozitës përkatëse të nenit 27.1 të kësaj Marrëveshjeje.